R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.1786/1 prot. Tiranë, më 01.08.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi një projektvendim.

MINISTRIA E FINANCAVE

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 10225/1 prot., datë 23.07.2024, administruar me tonën me nr. 1786 prot., datë 25.07.2024, përmes së cilës dërgohet për mendim projektvendimi "*Për krijimin e regjistrit për kthimin e garancive dhe kredive të pakthyera*", së bashku me relacionin shpjegues, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "*Zyra e Komisionerit*").

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit shoqërues, rezulton se krijimi i regjistrit për kthimin e garancive dhe kredive të pakthyera, bazohet në ligjin nr. 55/2023 "*Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera*" dhe ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 "*Për bazat e të dhënave shtetërore*". Konkretisht, projektvendimi parashikon se, regjistri elektronik, do të përbëhet nga të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, të cilat kanë në përmbajtje edhe të dhëna personale.

Në raport me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar (në vijim, *"Ligji"*), Zyra e Komisionerit vlerëson se, në pikën 3 të nenit 7 të Ligjit nr. 55/2023, parashikohet ngritja/krijimi i regjistrit për kthimin e garancive shtetërore (në vijim, *"Regjistri"*). Referuar nenit 11 të Ligjit nr. 55/2023, janë të përcaktuara institucionet ndaj të cilave do të merren informacion për identifikimin e pasurive të debitorëve nga Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera (në vijim, "*Agjencia*").

Në projektvendim, ndryshe nga parashikimet e nenit 11 të Ligjit nr. 55/2023, në rubrikën III *"Ndërlidhja me bazën e të dhënave"* janë të përfshira më shumë institucione ku, ndër të tjerat, në germën "b" të kësaj rubrike parashikohet ndërveprimi dhe me regjistrin e gjendjes civile.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, ndërveprimi i këtij regjistri elektronik me regjistra të palëve të treta me qëllim për të identifikuar pasuritë e debitorëve, legjitimohet vetëm nëse është e parashikuar në ligjin specifik, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Gjithashtu, sjellim në vëmendjen tuaj se, në Udhëzimin e përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 *"Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin"*, (në vijim, *"Udhëzimi nr. 463"*) të Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, janë parashikuar institucionet të cilat mund të marrin të dhëna personale nga shërbimi i Gjendjes Civile.

Konkretisht, më Aneksin nr. 1 janë të listuara institucionet të cilat mund të aksesojnë në regjistrin e gjendjes civile, nga ku konstatohet se, Agjencia nuk është e përfshire në këtë listë.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në projektvendim duhet të reflektohet ndërlidhja e këtij regjistri me bazën e të dhënave me palët e treta (institucionet e tjera) për aq sa është parashikuar në ligjin nr. 55/2023. Ndërsa, sa i takon ndërveprimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Agjencia duhet të marrë masa për të përmbushur detyrimet e parashikuar në Udhëzimin nr. 463, në mënyrë që të përfshihet në listën e institucioneve që kanë akses në regjistrin e gjendjes civile.

Mungesa e një rregullimi të tillë bie ndesh me parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi